72169910	- - - Te petezuara ne te nxehte, te terhequra ne te nxehte apo te stampuara ne te nxehte, jo me tej te punuara sesa te veshura (ECSC)	15	7216 99 00	- - Te tjera	15
72169990	- - - Te tjera	15			
72173011	- - - - Te veshura me baker	15	7217 30 41	- - - Te veshur me baker	15
72173031	- - - - Te veshura me baker	15			
72173019	- - - - Te tjera	15	7217 30 49	- - - Te tjera	15
72173039	- - - - Te tjera	15			
72179010	- - - Me nje maksimum te seksionit kryq seksional prej me pak se 0,8 mm	15	7217 90 20	- - Qe permban ne peshe me pak se 0,25 % karbon	15
72179030	- - - Me nje maksimum te seksionit kryq seksional prej 0,8 mm apo me shume	15			
72189111	- - - - Qe permbajne ndaj peshes 2,5 % apo me shume nikel (ECSC)	5	7218 91 10	- - - Qe permban ne peshe 2,5 % apo me shume nikel	5
72189190	- - - - Te farketuara	5			

NK 2003	Pershkrimi	Niveli i Tarifes	NK 2005	Pershkrimi	Niveli i Tarifes
72189119	- - - - Qe permbajne ndaj peshes me pak se 2,5 % nikel (ECSC)	5	218 91 80	- - - Qe permban ne peshe me pak se 2,5 % nikel	5
72189190	- - - - Te farketuara	5			
72189991	- - - - - Te seksionit kryq rrethor apo shumekendeshe	5	7218 99 80	- - - - I farketuar	5
72189999	- - - - - Te tjera	5			
72199010	- - Jo me tej te punuara sesa te trajtuara ne siperfaqe, duke perfshire veshjen, apo thjesht te prera ne forma ndryshe nga drejtkendeshe (duke perfshire katrorin) (ECSC)	15	7219 90 00	- Te tjera	15
72199090	- - Te tjera	15			
72202010	- - Te nje gjeressie me teper se 500 mm (ECSC)	15	7220 20 21	- - - 2,5 % apo me shume nikel	15
72202031	- - - - 2,5 % apo me shume nikel	15			
72202010	- - Te nje gjeressie me teper se 500 mm (ECSC)	15	7220 20 29	- - - Me pak se 2,5 % nikel	15
72202039	- - - - Me pak se 2,5 % nikel	15			
72202010	- - Te nje gjeressie me teper se 500 mm (ECSC)	15	7220 20 41	- - - 2,5 % apo me shume nikel	15
72202051	- - - - 2,5 % apo me shume nikel	15			
72202010	- - Te nje gjeressie me teper se 500 mm (ECSC)	15	7220 20 49	- - - Me pak se 2,5 % nikel	15
72202059	- - - - Me pak se 2,5 % nikel	15			
72202010	- - Te nje gjeressie me teper se 500 mm (ECSC)	15	7220 20 81	- - - 2,5 % apo me shume nikel	15
72202091	- - - - 2,5 % apo me shume nikel	15			
72202010	- - Te nje gjeressie me teper se 500 mm (ECSC)	15	7220 20 89	- - - Me pak se 2,5 % nikel	15
72202099	- - - - Me pak se 2,5 % nikel	15			
72209011	- - - Jo me tej te punuara sesa te trajtuara ne siperfaqe, perfshire veshjen (ECSC)	15	7220 90 00	- Te tjera	15
72209019	- - - Te tjera	15			
72209031	- - - - Te petezuara ne te nxehte, jo me tej te punuara sesa te veshura (ECSC)	15			

NK 2003	Pershkrimi	Niveli i Tarifes	NK 2005	Pershkrimi	Niveli i Tarifes
72209039	- - - - Te tjera	15			
72209090	- - - Te tjera	15			
72221121	- - - - 2,5 % apo me shume nikel	15	7222 11 81	- - - - 2,5 % apo me shume nikel	15
72221191	- - - - 2,5 % apo me shume nikel	15			
72221129	- - - - Me pak se 2,5 % nikel	15	7222 11 89	- - - - Me pak se 2,5 % nikel	15
72221199	- - - - Me pak se 2,5 % nikel	15			
72223010	- - Te petezuara ne te nxehte, te terhequra ne te nxehte apo te stampuara ne te nxehte, jo me tej te punuara sesa te veshura (ECSC)	15	7222 30 97	- - Te tjera	15
72223098	- - Te tjera	15			
72224091	- - - - - Te fituara nga produktet e petezuara flete	15	7222 40 50	- - Jo punuar me tej se formuar ne te ftohte apo perfunduar ne te ftohte	15
72224093	- - - - - Te tjera	15			

72224030	- - - Te petezuara ne te nxehte, te terhequra ne te nxehte apo te stampuara ne te nxehte, jo me tej te punuara sesa te veshura (ECSC)	15	7222 40 90	- - Te tjera	15
72224099	- - - - Te tjera	15			
72241000	- Lingota dhe forma te tjera primare	2	722410 7224 10 10 7224 10 90	- Lingota dhe forma te tjera primare - - Prej celiku instrumentash - - Te tjera	2 2
72249008	- - - - - Te tjerqa (ECSC)	10	7224 90 02	- - Prej celiku instrumentash	10
72249015	- - - - Te tjera (ECSC)	10			
72249019	- - - Te farketuara	10			
72249039	- - - - Te tjera (ECSC)	10			
72249091	- - - - Te seksionit kryq rrethor apo shumekendesh	10			
72249099	- - - - Te tjera	10			
72249001	- - - - - Prej celiku me prerje te shpejte (ECSC)	10	7224 90 03	- - - - - Prej celiku high-speed	10

NK 2003	Pershkrimi	Niveli i Tarifes	NK 2005	Pershkrimi	Niveli i Tarifes
72249008	- - - - - Te tjerqa (ECSC)	10	7224 90 07	- - - - - Te tjera	10
72249015	- - - - Te tjera (ECSC)	10	7224 90 14	- - - - - Te tjera	10
72249019	- - - Te farketuara	10	7224 90 18	- - - - I farketuar	10
72249039	- - - - Te tjera (ECSC)	10	7224 90 38	- - - - - Te tjera	10
72249091	- - - - Te seksionit kryq rrethor apo shumekendesh	10	7224 90 90	- - - - I farketuar	10
72249099	- - - - Te tjera	10			
72252020	- - Jo me tej te punuara sesa te petezuara; jo me tej te punuara sesa te trajtuara ne siperfaqe, duke perfshire veshjen apo thjesht prerjen ne forma ndryshe nga drejtkendeshe (duke perfshire katrorin) (ECSC)	15	7225 20 00	- Prej celiku high-speed	15
72252090	- - Te tjera	15			
72253000	- Te tjera, jo me tej te punuara sesa te petezuara ne te nxehte, ne spirale	15	7225 30 10	- - Prej celiku instrumentash	15
			7225 30 90	- - Te tjera	15
72254020	- - Te nje trashesie me teper se 15 mm (ECSC)	15	7225 40 12	- - Prej celiku instrumentash	15
			7225 40 40	- - Te tjera:	15
				- - - Te nje trashesie qe e kalon 10 mm	15
72254050	- - Te nje trashesie prej 4,75 mm apo me shume por jo me teper se 15 mm (ECSC)	15	7225 40 60	- - - Te te trashesie prej 4,75 mm apo me shume por qe nuk e kalon 10 mm	15
72254080	- - Te nje trashesie prej me pak se 4,75 mm (ECSC)	15	7225 40 90	- - - Te nje trashesie prej me pak se 4,75 mm	15
72259110	- - - Jo me tej te punuara sesa te trajtuara ne siperfaqe, duke perfshire veshjen apo thjesht te prera ne forma ndryshe nga drejtkendeshe (duke perfshire katrorin) (ECSC)	15	7225 91 00	- - Te veshur apo te mbuluar elektrolitikisht me zink	15
72259190	- - - Te tjera	15			
72259210	- - - Jo me tej te punuara sesa te trajtuara ne siperfaqe, duke perfshire veshjen apo thjesht te prera ne forma ndryshe nga drejtkendeshe (duke perfshire katrorin) (ECSC)	15	7225 92 00	- - Te veshura apo te mbuluara ndryshe me zink	15

NK 2003	Pershkrimi	Niveli i Tarifes	NK 2005	Pershkrimi	Niveli i Tarifes
72259290	- - - Te tjera	15			
72259910	- - - Jo me tej te punuara sesa te trajtuara ne siperfaqe, duke perfshire veshjen apo thjesht te prera ne forma ndryshe nga drejtkendeshe (duke perfshire katrorin) (ECSC)	15	7225 99 00	- - Te tjera	15
72259990	- - - Te tjera	15			
72261110	- - - Te nje gjeressie me teper se 500 mm (ECSC)	15	7226 11 00	- - Me karakter te orientuar	15
72261190	- - - Te nje gjeressie jo me teper se 500 mm	15			
72261930	- - - - Te nje gjeressie me teper se 500 mm (ECSC)	15	7226 19 80	- - - Te tjera	15
72261990	- - - - Te nje gjeressie jo me teper se 500 mm	15			
72262020	- - Jo me tej te punuara sesa te petezuara ne te nxehte; te nje gjeressie jo me teper se 500 mm, te petezuara ne te nxehte, jo me tej te punuara sesa te veshura; te nje gjeressie me teper se 500 mm, jo me tej te punuara sesa te petezuara ne te ftohte a	15	7226 20 00	- Prej hekuri high-speed	15
72262080	- - Te tjera	15			
			7226 91 20	- - - Prej celiku instrumentash	15
72269110	- - - Te nje trashesie prej 4,75 mm apo me shume (ECSC)	15	7226 91 91	- - - - Te nje trashesie prej 4,75 mm apo me shume	15
72269190	- - - Te nje trashesie prej me pak se 4,75 mm (ECSC)	15	7226 91 99	- - - - Te nje trashesie prej me pak se 4,75 mm	15
72269210	- - - Te nje gjeressie me teper se 500 mm (ECSC)	15	7226 92 00	- - Jo e punuar me tej se mbeshjelle ne te ftohte (cold-reduced)	15
72269290	- - - Te nje gjeressie jo me teper se 500 mm	15			
72269320	- - - Te nje gjeressie jo me teper se 500 mm, te petezuara ne te nxehte, jo me tej te punuara sesa te veshura; te nje gjeressie me teper se 500 mm, jo me tej te punuara sesa te trajtuara ne siperfaqe, duke perfshire veshjen (ECSC)	15	7226 93 00	- - I veshur apo I mbuluar elektrolitikisht me zink	15
72269380	- - - Te tjera	15			

NK 2003	Pershkrimi	Niveli i Tarifes	NK 2005	Pershkrimi	Niveli i Tarifes
72269420	- - - Te nje gjeressie jo me teper se 500 mm, te petezuara ne te nxehte, jo me tej te punuara sesa te veshura; te nje gjeressie me teper se 500 mm, jo me tej te punuara sesa te trajtuara ne siperfaqe, duke perfshire veshjen (ECSC)	15	7226 94 00	- - Veshur apo mbuluar ndryshe me zink	15
72269480	- - - Te tjera	15			
72269920	- - - Te nje gjeressie jo me teper se 500 mm, te petezuara ne te nxehte, jo me tej te punuara sesa te veshura; te nje gjeressie me teper se 500 mm, jo me tej te punuara sesa te trajtuara ne siperfaqe, duke perfshire veshjen (ECSC)	15	7226 99 00	- - Te tjera	15
72269980	- - - Te tjera	15			
72281010	- - Jo me tej te punuara sesa te petezuara ne te nxehte, te terhequra ne te nxehte apo te stampuara ne te nxehte (ECSC)	15	7228 10 20	- - Jo l punuar me tej se mbeshjelle ne te nxehte, l leshuar ne te nxehte apo shtrydhur; mbeshjelle ne te nxehte apo l leshuar ne te nxehte apo shtrydhur, jo punuar me tej se e veshur	15
72281030	- - - Te petezuara ne te nxehte, te terhequra ne te nxehte apo te stampuara ne te nxehte, jo me tej te punuara sesa te veshura (ECSC)	15			
72282011	- - - Te seksionit kryq drejtkendesh (perfshire katrorin), te rrumbullakosur ne te kater faqet (ECSC)	15	7228 20 10	- - Me seksion prerje terthore drejtkendore (ndryshe nga katrori), mbeshjelle ne te nxehte ne te kater faqet	15
72282030	- - - Te petezuara ne te nxehte, te terhequra ne te nxehte apo te stampuara ne te nxehte, jo me tej te punuara sesa te veshura (ECSC)	15			
72282060	- - - Te tjera	15			
72282019	- - - Te tjera (ECSC)	15	7228 20 91	- - - Jo punuar me tej se mbeshjelle ne te nxehte, leshuar ne te nxehte apo shtryshur; mbeshjelle ne te nxehte, leshuar ne te nxehte apo shtrydhur, jo punuar me tej se l veshur	15
72282030	- - - Te petezuara ne te nxehte, te terhequra ne te nxehte apo te stampuara ne te nxehte, jo me tej te punuara sesa te veshura (ECSC)	15			

NK 2003	Pershkrimi	Niveli i Tarifes	NK 2005	Pershkrimi	Niveli i Tarifes
72282060	- - - Te tjera	15	7228 20 99	- - - Te tjera	15
72285070	- - - Te seksionit kryq seksional drejtkendesh (duke perfshire katrorin), te rrumbullakosura new te kater faqet	15	7228 50 80	- - - Te tjera	15
72285089	- - - Te tjera	15			
72286010	- - Te petezuara ne te nxehte, te terhequra ne te nxehte apo te stampuara ne te nxehte, jo me tej te punuara sesa te veshura (ECSC)	15	7228 60 20	- - Prej celiku instrumentash	15
72286081	- - - Prej celiku veglash	15			
72286010	- - Te petezuara ne te nxehte, te terhequra ne te nxehte apo te stampuara ne te nxehte, jo me tej te punuara sesa te veshura (ECSC)	15	7228 60 80	- - Te tjera	15
72286089	- - - Te tjera	15			
72287031	- - - Te petezuara ne te nxehte, te terhequra ne te nxehte apo te stampuara ne te nxehte, jo me tej te punuara sesa te veshura (ECSC)	15	7228 70 90	- - Te tjera	15
72287091	- - - - Jo me tej te punuara sesa te formuara ne te ftohte apo te perfunduara ne te ftohte	15			
72287099	- - - - Te tjera	15			
72288010	- - Prej celiku te lidhur (ECSC)	15	7228 80 00	- Kallepe dhe thupra per trapane Hollow	15
72288090	- - Prej celiku jo te lidhur (ECSC)	15			
73021031	- - - - Te nje peshe per meter prej 20 Kg apo me shume (ECSC)	15	7302 10 21	- - - - Shina te tipit vignole	
			7302 10 23	- - - - Te nje peshe per meter prej 46 kg apo me shume	15
73021039	- - - - Te nje peshe per meter prej me pak se 20 kg (ECSC)	15	7302 10 29	- - - - Te nje peshe per meter prej 27 kg apo me shume por me pak se 46 kg	15
			7302 10 40	- - - - Te nje peshe per meter prej me pak se 27 kg	15
			7302 10 50	- - - - Shine ne forme ulluku	15
				- - - - Te tjera	

NK 2003	Pershkrimi	Niveli i Tarifes	NK 2005	Pershkrimi	Niveli i Tarifes
73024010	- - Te rumbullakosura (ECSC)	15	7302 40 00	- Pllake bashkuese dhe sole plates	15
73024090	- - Te tjera	15			
73029020	- - Shina kontrolli dhe vagon-shtrat (cross-ties)(ECSC)	15	7302 90 00	- Te tjera	15
73029030	- - Kapeset e shinave, pllakat baze dhe lidheset	15			
73029090	- - Te tjera	15			
73045111	- - - - Jo me teper se 4,5 m	15	7304 51 12	- - - - Qe nuk l kalon 0,5 m	15
			7304 51 18	- - - Qe l kalon 0,5 m	15
73045119	- - - - Me teper se 4,5 m	15			
73045931	- - - - Jo me teper se 4,5 m	15	7304 59 32	- - - - Qe nuk l kalon 0,5 m	15
			7304 59 38	- - - - Qe l kalon 0,5 m	15
73045939	- - - - Me teper se 4,5 m	15			
73052090	- - Te tjera	15	7305 20 00	- Detale te derdhura te nje lloji te perdorur ne shpim per naftë dhe gaz	15
73052010	- - Te salduar per se gjati	15			
73066031	- - - - Jo me teper se 2 mm	15	7306 60 32	- - - - - Prej celiku te pandryshkshem	15
			7306 60 34	- - - - - Te tjera	15
73066039	- - - Me teper se 2 mm	15	7306 60 36	- - - - - Prej celiku te pandryshkshem	15
			7306 60 38	- - - - - Te tjera	15
73066090	- - - Te seksioneve te tjera	15	7306 60 91	- - - - Prej celiku te pandryshkshem	15
			7306 60 99	- - - - Te tjera	15
73269080	- - Lidhesit per kabllot me fibra optike	15	7326 90 98	- - - Te tjera	15
73269097	- - - Te tjera	15			
81124011	- - - l paperpunuar; i puderzuar	2	8112 40 10	- - l paperpunuar; pjese dhe mbetje; pluhura	2
81124019	- - - Mbetje dhe kthime	2			

NK 2003	Pershkrimi	Niveli i Tarifes	NK 2005	Pershkrimi	Niveli i Tarifes
84472010	- - Te operuara me dore	2	8447 20 20	- - Makinat e thurjes me ind (perfshire tipin Raschel); makinat me lidhje sycka	2
84472092	- - - Makinat e thurjes me ind (perfshire tipin Raschel); makinat me lidhje syckash	2			
84472010	- - Te operuara me dore	2	8447 20 80	- - Te tjera	2
84472098	- - - - Te tjera	2			
84482010	- - Prej gize te derdhur apo celiku te derdhur	2	8448 20 00	- Pjese dhe aksesore te makinave te kreut 8444 apo makinerite e tyre ndihmese	2
84482090	- - Te tjera	2			
84238910	- - - Peshe urat	2	8423 89 00	- - Te tjera	2
84238990	- - - Te tjera	2			
			8507 80 94	- - - Jon litiumi	10
85078099	- - - Te tjera		8507 80 98	- - - Te tjera	10
85167910	- - - Ngrohesisht e pjatave	10	8516 79 70	- - - Te tjera	10
85167980	- - - Te tjera	10			
85281272	- - - - - Me nje rezolute vertikale jo me teper se 700 rrjeshta	10	8528 12 70	- - - - - Me parametra skanues qe l kalojne 625 rrjeshta	10
85281276	- - - - - Me nje rezolute vertikale me 700 rrjeshta apo me shume	10			
89039191	- - - - Me peshe jo me shume se 100 kg secila	2	8903 91 92	- - - - Te nje gjatesie qe nuk l kalon 7,5 m	2
89039193	- - - - Me gjatesi jo me shume se 7,5 m	2			
91112010	- - Te galvanizuar me ar apo argjend	15	9111 20 00	- Kasa me baze metal, nese jane apo jo te veshura me flori apo argjend	15
91112090	- - Te tjera	15			
91139030	- - Prej materjaleve plastike	15	9113 90 80	- - Te tjera	15
91139090	- - Te tjera	15			
92029090	- - Te tjera	2	9202 90 80	- - Te tjera	2
92029010	- - Harpat	2			

NK 2003	Pershkrimi	Niveli i Tarifes	NK 2005	Pershkrimi	Niveli i Tarifes
92030010	- Organot me gypa dhe tastjere	2	9203 00 00	Organo me gypa dhe tastjere; Harmoniume dhe instrumenta te ngjashem me tastiere pa pipeza metalike	2
92030090	- Te tjera	2			
93020010	- Me kaliber 9 mm dhe me lart	15	9302 00 00	Revolvere dhe pistoleta, te ndryshme nga ato te kreut 9303 apo 9304	15
93020090	- Te tjera	15			
93052930	- - - Blloqet e shtratit te armeve vetem te dhena forme	15	9305 29 00	- - Te tjera	15
93052995	- - - Te tjera	15			
94060010	- Prej druri	2	9406 00 11	- Shtepi te levizshme	2
94060039	- - Te tjera	2		- - Te tjera	
			9406 00 20	-- Prej druri	2
			9406 00 38	- - Prej hekuri ose celiku:	2
94060090	- Prej materialeve te tjera	2		- - - Te tjera	2
			9406 00 80	- - Prej materialeve te tjera	2
96089910	- - - Mbajteset e penave, mbajteset e lapsave dhe mbajtes te ngjashem	15	9608 99 20	- - - Prej metali	15
96089992	- - - - Prej metali	15			
96089910	- - - Mbajteset e penave, mbajteset e lapsave dhe mbajtes te ngjashem	15	9608 99 80	- - - Te tjera	15
96089998	- - - - Te tjera	15			

(1) – sipas angazhimeve te OBT-se per nje diferencim te tille tarife merr prioritet niveli me i ulet

(2) – sipas skedulit OBT 2005

LIGJ
Nr.9331, datë 6.12.2004

**PËR DISA NDRYSHIME DHE SHITESA NË LIGJIN NR.8977, DATË 12.12.2002 “PËR
SISTEMIN E TAKSAVE NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË”, I NDRYSHUAR**

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1 dhe 155 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Në ligjin nr.8977, datë 12.12.2002 “Për sistemin e taksave në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, bëhen këto ndryshime e shtesa:

Neni 1

Në nenin 4 bëhen këto ndryshime:

1. Pikat 3 dhe 17 shfuqizohen.
2. Pika 21 ndryshohet si më poshtë:
“21. Taksa vjetore e qarkullimit rrugor të mjeteve.”.

Neni 2

Në nenin 5 bëhen këto ndryshime e shtesa:

1. Pikat 3 e 17, si dhe lidhjet nr.3 e nr.8 të ligjit shfuqizohen.
2. Shkronjat “a” të nënpikave 5.1 e 5.2 të pikës 5 shfuqizohen.
3. Pas nënpikës 5.2 shtohet nënpika 5.3 me këtë përmbajtje:
“5.3. Taksa e importimit të autovecurave llogaritet sipas formulës:
Taksa fikse x Cilindrata e motorit x Koeficienti i viteve të përdorimit.
- “Taksa fikse” për çdo autovecurë me benzinë caktohet 20 mijë lekë dhe për çdo autovecurë me naftë 25 mijë lekë.
- “Cilindrata e motorit” është vëllimi i dhomës së djegies së motorit, i shprehur në centimetër kub (cm³).
- “Vite përdorimi” quhet diferenca ndërmjet vitit kur mjeti hyn në doganën shqiptare me vitin e prodhimit.

Koeficienti i viteve të përdorimit është si më poshtë:

deri në 2 vjet nga data e prodhimit	koeficienti është 0,001
mbi 2 deri në 4 vjet nga data e prodhimit	koeficienti është 0,0015
mbi 4 deri në 7 vjet nga data e prodhimit	koeficienti është 0,0018
mbi 7 deri në 10 vjet nga data e prodhimit	koeficienti është 0,002
mbi 10 vjet nga data e prodhimit	koeficienti është 0,003

4. Pika 21 ndryshohet si më poshtë:

“21. Taksa vjetore e qarkullimit rrugor të mjeteve caktohet sipas lidhjes nr.10 që i bashkëlidhet ligjit dhe është pjesë përbërëse e tij.”.

Neni 3

Në nenin 6 bëhen këto ndryshime:

1. Pikat 3, 17 dhe 18 shfuqizohen.
2. Pika 21 ndryshohet si më poshtë:

“21. Për taksën vjetore të qarkullimit rrugor të mjeteve ngarkohet Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor. Drejtoria e Rendit dhe e Sigurisë Publike në Ministrinë e Rendit Publik, nëpërmjet degëve të saj në rrethe, kontrollon pagimin e taksës nga zotëruesit e mjeteve. Kjo taksë arkëtohet në çastin e kontrollit teknik më të parë të mjeteve.”.

Neni 4

Shkronja “b” e nenit 8 ndryshohet si më poshtë:

“b) taksa vjetore e qarkullimit rrugor të mjeteve.”.

Neni 5

Në nenin 9 bëhen këto ndryshime:

1. Pikat 3 dhe 17 shfuqizohen.
2. Pika 21 ndryshohet si më poshtë:

“21. Për taksën vjetore të qarkullimit rrugor të mjeteve nga të cilat:	8 për qind
- Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor	6 për qind
- Drejtoria e Rendit dhe e Sigurisë Publike në Ministrinë e Rendit Publik	2 për qind

Neni 6

Në nenin 10 bëhen këto ndryshime:

1. Paragrafi i parë i pikës 3 ndryshohet si më poshtë:
“3. Përfshihen nga pagimi i taksës vjetore të qarkullimit rrugor të mjeteve:”.
2. Pika 10 shfuqizohet.

Neni 7

Në lidhjen nr.2 të kreut II “Taksat për lëshimin, verifikimin dhe legalizimin e dokumenteve”, pika 7 ndryshohet si më poshtë:

“7. Legalizimi i dokumentit nga përfaqësitë për shtetasit shqiptarë 20 EURO”

Neni 8

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**Shpallur me dekretin nr.4435, datë 17.12.2004 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,
Alfred Moisiu**

TAKSA VJETORE E QARKULLIMIT RRUGOR TË MJETEVE

Nr.	Tipi i Mjetit	Masa e taksës në lekë
1	Ciklomotorë	...
2	Motomjete	500
3	Autoveturë: ≤ 4+1 vende, benzinë ≤ 4+1 vende, naftë > 4+1 deri me 8+1 vende, benzinë > 4+1 deri me 8+1 vende, naftë	7 000 10 000 25 000 35 000
4	Automjet transporti i përzier: ≤ 3 tonë > 3 tonë deri 3,5tonë	26 000 37 000
5	Kamionë: Mbi 3,5 tonë – 7,5 tonë Mbi 7,5 tonë – 18 tonë Mbi 18 tonë	46 000 64 000 92 000
6	Autobuz : Nga 8+1 deri 32+1 vende Mbi 32+1 deri 42+1 vende Mbi 42+1 vende dhe artikularë	34 000 43 000 53 000
7	Automjet për përdorim të veçantë: Deri 3,5 tonë Mbi 3,5 tonë deri 7,5 tonë, Mbi 7,5 tonë deri 18 tonë Mbi 18 tonë	37 000 46 000 64 000 92 000
8	Automjet për transport të veçantë: ≤ 3,5 tonë Mbi 3,5 tonë deri 7,5 tonë Mbi 7,5 tonë deri 18 tonë Mbi 18 tonë	37 000 46 000 66 000 106 000
9	Tërheqës rrugor	50 000
10	Autokamp	46 000
11	Rimorkio: Deri 750 kg (karrel) shtojcë Mbi 750 kg deri në 1500 kg Mbi 1500 kg deri 7000 kg Mbi 7000 kg	5 000 8 000 10 000 17 000
12	Gjysmë rimorkio : ≤ 7000 kg dhe > 7000 kg	36 000
13	Makina bujqësore : Deri 3,5 tonë Mbi 3,5 tonë deri 7,5 tonë Mbi 7,5 tonë deri 18 tonë Mbi 18 tonë	2 000 2 000 2 000 2 000
14	Makina teknologjike: Deri 3,5 tonë Mbi 3,5 tonë deri 7,5 tonë Mbi 7,5 tonë deri 18 tonë Mbi 18 tonë	20 000 38 000 48 000 54 000
15	Mjete rrugore të veçanta: Deri 3,5 tonë Mbi 3,5 tonë deri 7,5 tonë Mbi 7,5 tonë deri 18 tonë Mbi 18 tonë	37 000 46 000 64 000 92 000

LIGJ
Nr.9332, datë 6.12.2004

**PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA NË LIGJIN NR.7928, DATË 27.4.1995 “PËR
TATIMIN MBI VLERËN E SHTUAR”, I NDRYSHUAR**

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1 dhe 155 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Në ligjin nr.7928, datë 27.4.1995 “Për tatimin mbi vlerën e shtuar”, i ndryshuar, bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

Neni 1

Pika 1/1 e nenit 3 shfuqizohet.

Neni 2

Pas pikës 6 të nenit 13 shtohet pika 7 me këtë përmbajtje:

“7. Kur mallrat transferohen në bazë të një kontrate, e cila parashikon marrjen me qira ose shitjen me këste, pavarësisht nga çasti i kalimit të pronësisë, detyrimi për TVSH-në lind mbi vlerën e plotë të mallit dhe llogaritet mbi pagesat e vlerës së plotë të kësteve për mallin e vënë në dispozicion për përdoruesin.”.

Neni 3

Në nenin 20 bëhen ndryshimet e mëposhtme:

1. Pika 2 ndryshohet si më poshtë:

“ 2. Furnizimi i ndërtesave është një furnizim i përjashtuar deri më 31 dhjetor 2005.”.

2. Pas pikës 3 shtohen pikat 4 dhe 5 me këtë përmbajtje:

“4. Furnizimi i ndërtesave të banimit dhe i tokës mbi të cilën ato qëndrojnë, me përjashtim të shitjes së parë të ndërtesave të reja të banimit, është furnizim i përjashtuar, duke filluar nga data 1 janar 2006.

5. Dhënia me qira e ndërtesave të banimit, të cilat janë tatuar me TVSH në shitje, është furnizim i përjashtuar duke filluar nga data 1 janar 2006.”.

Neni 4

Pas nenit 25/5 shtohet neni 25/6 me këtë përmbajtje:

“Neni 25/6

1. Kryerja nga nënkontraktorët e furnizimit të shërbimeve të përpunimit të mallrave joshqiptare, të destinuara për t'u rieksportuar për personat e tatueshëm të autorizuar mbi bazën e dispozitave që parashikon Kodi Doganor, për operacione nën regjimin e përpunimit aktiv, është furnizim i përjashtuar.

2. Ministri i Financave përcakton me udhëzim dokumentacionin e nevojshëm për zbatimin e përjashtimit.”.

Neni 5

Në nenin 26/1, pas shkronjës “dh” shtohen shkronjat “e” dhe “ë” me këtë përmbajtje:

“e) importimi i mallrave nga NATO-ja dhe organizmat e saj në kuadër të operacioneve, në bazë të marrëveshjeve ndërkombëtare;

ë) importimi i materialeve ushtarake për Forcat e Armatosura, të dhuruara nga vendet e Aleancës së NATO-s dhe ato partnere.”.

Neni 6

Shkronja “c” e nenit 31 ndryshohet si më poshtë:

“c) furnizimet e mallrave e të shërbimeve, në lidhje me transportin ndërkombëtar të mallrave ose të pasagjerëve, me përjashtim të shërbimeve navigacionale ajrore në territorin e Republikës së Shqipërisë.”.

Neni 7

Neni 43 “E drejta e ankimit” ndryshohet si më poshtë:

“Neni 43

E drejta e ankimit

1. Çdo person, që ka kërkuar një rishqyrtim në mbështetje të nenit 42, nëse nuk është dakord për ndonjë arsye me rezultatet e rishqyrtimit, ka të drejtë të ankohet në Komisionin e Apelit të Tatimeve dhe më pas në gjykatë kundër vlerësimit tatimor.

2. Ankimi bëhet brenda 30 ditëve nga data e rishqyrtimit dhe në të duhet të paraqiten arsyet përse personi që bën ankimin nuk ka rënë dakord me vlerësimin tatimor dhe rishqyrtimin.

3. Në gjykimin e një ankimi, Komisioni i Apelit të Tatimeve ose gjykata ka të drejtë të vendosë që vlerësimi tatimor, kundër të cilit personi ankohet, të konfirmohet, të ndryshohet ose të anulohet.

4. Organet tatimore, në mbështetje të këtij neni, zbatojnë çdo vendim të gjykatës.”.

Neni 8

Pika 2 e nenit 49 shfuqizohet.

Neni 9

Shkronja “a” e pikës 2 të nenit 50 ndryshohet si më poshtë:

“a) personi i tatueshëm ka bartur një shumë të kreditimit tatimor për 3 muaj radhazi në bazë të pikës 1 të këtij neni ”.

Neni 10

Shkronja “b” e nenit 53 “Interesat për rimbursimin” ndryshohet si më poshtë:

“ b) kur organet tatimore nuk bëjnë rimbursimin e TVSH-së për një person, në përputhje me nenin 50, brenda 30 ditëve nga data e paraqitjes së kërkesës në njërin nga format e përcaktuara në shkronjat “a”, “b” dhe “c” të pikës 3 të nenit 39 të ligjit nr.8560, datë 22.12.1999 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, detyrohen të paguajnë interesat e përcaktuar në nenin 44 të ligjit “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.”.

Neni 11

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**Shpallur me dekretin nr.4436, datë 17.12.2004 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,
Alfred Moisiu**

LIGJ

Nr.9333, datë 6.12.2004

**PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË LIGJIN NR.8560, DATË 22.12.1999
"PËR PROCEDURAT TATIMORE NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË", I NDRYSHUAR**

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1 dhe 155 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

**KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

VENDOSI:

Në ligjin nr.8560, datë 22.12.1999 "Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

Neni 1

Neni 9 "Rregullat administrative" ndryshohet si më poshtë:

**"Neni 9
Rregullat administrative**

1. Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve mund të nxjerrë rregulla administrative, që sqarojnë pozicionin zyrtar të administratës tatimore për zbatimin e legjislacionit tatimor.

Çdo njoftim i përgjithshëm administrativ është i detyrueshëm për administratën tatimore dhe për tatimpaguesit, me përjashtim të rastit kur gjykata provon se ai bie në kundërshtim me ligjin.

2. Njoftimet e përgjithshme administrative, që prekin të gjithë tatimpaguesit, janë të detyrueshme për t'u zbatuar vetëm pasi ato të jenë publikuar. Mënyra dhe organi i publikimit përcaktohen në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të ligjit."

Neni 2

Shkronja "b" e nenit 17 shfuqizohet.

Neni 3

Pas nenit 17 shtohen nenet 17/1 dhe 17/2 me këtë përmbajtje:

“Neni 17/1
Policia Tatimore

1. Në strukturën e Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve dhe të degëve të saj funksionon Policia Tatimore. Detyrat e Policisë Tatimore në Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve dhe në degët e saj përcaktohen në nenin 17/2 të këtij ligji dhe në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të tij.

2. Policia Tatimore ka në përbërje:

a) Drejtorinë e Policisë Tatimore, e cila është pjesë përbërëse e Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve;

b) sektorët ose zyrat e Policisë Tatimore, të cilat janë pjesë e degëve të tatimeve. Numri i punonjësve të sektorëve ose zyrave të Policisë Tatimore dhe organizimi i tyre propozohen nga kryetari i degës së tatimeve dhe miratohen nga Drejtori i Përgjithshëm.

3. Drejtoria e Policisë Tatimore varet nga Drejtori i Përgjithshëm i Tatimeve dhe raporton para tij. Sektorët ose zyrat e Policisë Tatimore varen nga kryetarët e degëve të tatimeve dhe raportojnë para tyre.

4. Drejtori i Policisë Tatimore është përgjegjës për drejtimin e Drejtorisë së Policisë Tatimore, ndërsa përgjegjësit e sektorëve ose të zyrave janë përgjegjës për drejtimin e sektorëve ose zyrave të policisë tatimore në degët e tatimeve. Personeli i Policisë Tatimore është i ndarë në oficerë dhe nënoficerë.

5. Punonjësit e Policisë Tatimore, gjatë kryerjes së detyrës, mbajnë uniformë dhe armë. Kur për qëllime operacionale lind nevoja që punonjësit e Policisë Tatimore të veprojnë pa uniformë, ata janë të detyruar të paraqesin dokumentin e identifikimit, të lëshuar nga Drejtori i Përgjithshëm i Tatimeve. Ministria e Rendit Publik, sipas kërkesës me shkrim të Drejtorit të Përgjithshëm të Tatimeve, pajis me armatim punonjësit e Policisë Tatimore. Armatimi përdoret në përputhje me dispozitat ligjore për armët. Mjetet e Policisë Tatimore janë me mbishkrimin “Policia Tatimore” dhe në to përdoren sinjalet pamore dhe zanore të përcaktuara në Kodin Rrugor.

6. Punonjësit e Policisë Tatimore janë të detyruar të zbatojnë Kodin e Etikës dhe dispozitat e Kodit të Etikës së Policisë të Shtetit, të përcaktuara në ligjin nr.8291, datë 25.2.1998 “Kodi i Etikës së Policisë”.

Neni 17/2
Detyrat e Policisë Tatimore

Policia Tatimore kryen këto detyra:

1. Verifikon regjistrimin dhe pajisjen me certifikatë tatimore të të gjithë personave që kryejnë veprimtari ekonomike.

2. Zbaton masat shtrënguese për mbledhjen e tatimeve, sipas urdhrit ekzekutiv të lëshuar nga kryetari i degës së tatimeve.

3. Zbaton sanksionet e ndërmarra nga dega e tatimeve, sipas urdhrit ekzekutiv të lëshuar nga kryetari i degës së tatimeve.

4. Verifikon dokumentimin e lëvizjes së mallrave dhe të udhëtarëve në të gjitha llojet e transportit.

5. Verifikon zbatimin nga tatimpaguesit e regjistruar në TVSH, të detyrimit për të lëshuar dokumentin e duhur për shitje malli ose shërbimi.

6. Verifikon zbatimin e ligjit “Për taksën vendore mbi biznesin e vogël” dhe të kreut III “Tatimi i thjeshtuar mbi fitimin” të ligjit “Për tatimin mbi të ardhurat”, lidhur me detyrimin e tatimpaguesve për:

a) lëshimin e kuponit, të dëftesës dhe të faturës tatimore;

b) mbajtjen e librave të xhiros dhe të blerjeve;

c) afishimin e çmimeve përfundimtare të shitjes;

ç) dokumentimin e mallrave gjendje.

7. Verifikon përdorimin e pullave të akcizës dhe zbatimin e kërkesave të tjera për mallrat që i nënshtrohen akcizës dhe merr masa për zbatimin e sanksioneve të vendosura për shkeljen e ligjit “Për akcizat”.

8. Ndihmon veprimtarinë e inspektorëve të tjerë të administratës tatimore, kur këta të fundit e kërkojnë një gjë të tillë, gjatë zhvillimit të kontrolleve tatimore për të gjitha llojet e tatimeve të drejtpërdrejta ose të tërthorta pranë tatimpaguesve, duke vepruar në këtë rast si forcë mbështetëse.

9. Për zbatimin e pikave 1, 4, 5, 6 dhe 7 të këtij neni, punonjësit e Policisë Tatimore kanë të drejtë të vendosin në vend sanksionet e përcaktuara në këtë ligj ose në ligjet e veçanta tatimore.

10. Mbledh dhe raporton të dhëna që kanë të bëjnë me shmangien tatimore të tatimpaguesve.”.

Neni 4

Pika 1 e nenit 20 ndryshohet si më poshtë:

“1. Kryeministri, me propozimin e Ministrit të Financave, miraton numrin e përgjithshëm të punonjësve të administratës tatimore, strukturën e Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve dhe strukturën tip të degëve të tatimeve. Drejtori i Përgjithshëm i Tatimeve merr masat për rekrutimin e personelit në Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve dhe në degët e saj, në përputhje me ligjin nr. 8549, datë 11.11.1999 “Statusi i nëpunësit civil”. Për nëpunësit drejtues dhe specialistë ekzistues të administratës tatimore, periudha e provës për të fituar statusin e nëpunësit civil përfundon më 31 dhjetor 2005 dhe për ata të punësuar pas datës 31 dhjetor 2004, periudha e provës do të jetë në përputhje me ligjin nr.8549, datë 11.11.1999 “Statusi i nëpunësit civil””.

Neni 5

Pika 3 e nenit 20/1 ndryshohet si më poshtë:

“3. Marrëdhëniet juridike të punës për punonjësit e Policisë Tatimore dhe për personelin ndihmës të administratës tatimore rregullohen me kontratë, sipas dispozitave të Kodit të Punës.”.

Neni 6

Neni 20/3 shfuqizohet.

Neni 7

Pika 3 e nenit 30 ndryshohet si më poshtë:

“3. Të gjithë tatimpaguesit regjistrohen vetëm një herë në çastin e fillimit të veprimtarisë ekonomike, para se të fillojnë biznesin. Përrjashtimisht për vitin 2005, tatimpaguesit e taksës vendore mbi biznesin e vogël dhe/ose të tatimit të thjeshtuar mbi fitimin, reregjistrohen brenda datës 20 mars.”.

Neni 8

Pika 1 e nenit 32 ndryshohet si më poshtë:

“1. Tatimpaguesit kanë të drejtë të kërkojnë të çregjistrohen me vendim gjykate, vetëm pasi të kenë paguar të gjitha detyrimet tatimore të papaguara dhe pasi të kenë paraqitur bilancin e mbylljes.

a) Gjykata njofton organin tatimor për kërkesën për çregjistrim të tatimpaguesit. Organi tatimor, brenda 45 ditëve nga data e njoftimit, është i detyruar të verifikojë situatën tatimore dhe, kur është e nevojshme, të ushtrojë kontrollin në vend të veprimtarisë së tatimpaguesit që kërkon të çregjistrohet, të paraqitur në bilancin e mbylljes.

b) Kur organi tatimor, brenda 45 ditëve nga data e njoftimit të marrë, paraqet kundërshtimin e tij, gjykata nuk mund të vendosë për çregjistrimin e tatimpaguesit. Organi tatimor është i detyruar ta tërheqë kundërshtimin vetëm pasi tatimpaguesi të ketë paguar të gjitha detyrimet e papaguara, të cilat i janë njoftuar me shkrim tatimpaguesit deri në datën e njoftimit për çregjistrim.

c) Nëse pas 45 ditësh nga data e njoftimit, organi tatimor nuk ka paraqitur ndonjë kundërshtim me shkrim, gjykata vendos për çregjistrimin e tatimpaguesit.”.

Neni 9

Në nenin 36/1 bëhet ky ndryshim:

Shifra “1 milion lekë” zëvendësohet me shifrën “300 mijë lekë”.

Neni 10

Pas nenit 36/4 shtohet neni 36/5 me këtë përmbajtje:

“Neni 36/5

Të gjithë tatimpaguesit, të cilët në veprimtarinë e tyre kryejnë, njëkohësisht, tregti me shumicë për tatimpagues të tjerë dhe tregti me pakicë për publikun e gjerë, janë të detyruar ta bëjnë një gjë të tillë në vende të veçanta, të ndara nga njëri-tjetri. Në një mjedis të deklaruar si vend për shitje me shumicë për tatimpagues të tjerë nuk mund të bëhen shitje me pakicë për publikun dhe e kundërta, në një mjedis të deklaruar si vend për shitje me pakicë për publikun nuk mund të bëhen shitje me shumicë për tatimpagues të tjerë. Kur pretendohet se në mjedisin e shitjes me pakicë janë kryer edhe shitje me shumicë, këto të fundit vlerësohen sikur të jenë shitur me çmimet e shitjes me pakicë.”.

Neni 11

Neni 39 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 39

Kthimi i tatimeve të paguara më tepër dhe rimbursimi i TVSH-së

1. Kur tatimpaguesi pretendon se shuma e paguar e një tatimi është më e madhe se shuma e vlerësuar si e pagueshme, ai mund të kërkojë kthimin e saj. Administrata tatimore është e detyruar të vendosë për kthimin ose jo të shumës së pretenduar si të paguar më tepër, duke e njoftuar me shkrim dhe në mënyrë të argumentuar tatimpaguesin brenda 60 ditëve nga data që ai ka paraqitur kërkesën me shkrim. Në çdo rast kthimi i shumës së paguar më tepër bëhet brenda 60 ditëve nga data e paraqitjes së kërkesës nga tatimpaguesi.

2. Në përputhje me ligjin “Për tatimin mbi vlerën e shtuar” dhe nenet e tij lidhur me rimbursimin, tatimpaguesi rimbursohet sipas kohës dhe procedurave të përcaktuara në ligjin “Për tatimin mbi vlerën e shtuar”.

3. Kthimi i shumave të paguara më tepër ose rimbursimi i TVSH-së mund të bëhet në një nga format e mëposhtme:

a) duke e kaluar shumën e paguar më tepër për llogari të pagimit të detyrimeve të tjera tatimore të papaguara të tatimpaguesit;

b) duke e kaluar shumën e paguar më tepër, me pëlqimin e tatimpaguesit, për llogari të pagimit të detyrimeve tatimore të mëvonshme të tatimpaguesit.

c) duke e kaluar shumën e paguar më tepër në llogarinë e tatimpaguesit.

4. Nëse shuma e paguar më tepër ose shuma e rimbursueshme nuk kthehet në një nga format e përcaktuara në shkronjat “a”, “b” dhe “c” të pikës 3 të këtij neni, brenda afatit të caktuar nga data e paraqitjes së kërkesës, e cila nuk është refuzuar ose është pranuar, sipas pikës 1 të këtij neni, administrata tatimore detyrohet të paguajë interesat e përcaktuar në nenin 44 të këtij ligji.”.

Neni 12

Neni 44 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 44

Interesat për pagesë të vonuar

1. Nëse një tatimpagues nuk paguan ndonjë detyrim tatimor brenda afatit të përcaktuar në legjislacionin tatimor, ai është i detyruar të paguajë interesa për pagesë të vonuar mbi shumën e papaguar, nga data e afatit deri në datën kur bëhet pagesa. Përfshihen nga pagimi i interesave për pagesë të vonuar tatimpaguesit, që i nënshtrohen tatimit të thjeshtuar mbi fitimin, sipas ligjit “Për tatimin mbi të ardhurat”.

2. Masa e interesit për pagesë të vonuar është 2 për qind në muajin e parë të vonesës ose pjesë të tij dhe 1 për qind në muaj për çdo muaj ose pjesë të tij që vijon.

3. Interesat për pagesë të vonuar vlerësohen dhe mbledhen në të njëjtën mënyrë, si dhe detyrimet e tjera tatimore.

4. Interesat për pagesë të vonuar janë të pagueshme automatikisht dhe nuk mund të falen ose të zvogëlohen nga asnjë autoritet.”.

Neni 13

Neni 55 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 55

Procedura e apelimit

1. Çdo tatimpagues ka të drejtë të apelojë kundrejt:

a) çdo vlerësimi që vendos një detyrim tatimor, interes ose gjoba për tatimpaguesin;

b) çdo vendimi të organit tatimor për pretendimin e tatimpaguesit për rimbursim ose përjashtim tatimor;

c) çdo akti zyrtar të organit tatimor për mënyrën e përcaktimit të detyrimit tatimor dhe për bazën ligjore të përcaktimit, si dhe ndaj çdo veprimi ose mosveprimi të organit tatimor;

ç) çdo vendimi ekzekutiv të posaçëm tatimor në lidhje me tatimpaguesin.

2. Apeli duhet të bëhet me shkrim dhe në formën e përcaktuar në udhëzimin e Ministrisë të Financave në zbatim të ligjit.

3. Tatimpaguesi duhet ta paraqesë apelin në shkallën më të ulët të sistemit të apelimit brenda 30 ditëve nga marrja e vlerësimit ose e njoftimeve të tjera zyrtare, me të cilat lidhet apeli.

4. Hierarkia e organeve të apelimit për tatimet, nga shkalla më e ulët në atë më të lartë, është si më poshtë:

a) kryetari i komunës ose i bashkisë për taksat dhe tarifatat vendore;

b) Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve për tatimet dhe taksat kombëtare, si dhe për detyrimet e tjera të administruara nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve;

c) Komisioni i Apelit të Tatimeve për të gjitha llojet e detyrimeve të administruara nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve;

ç) gjykatat.

5. Një apelim nuk mund të shqyrtohet në një shkallë më të lartë të hierarkisë së apelimit pa qenë shqyrtuar më parë nga shkalla më e ulët pararendëse, përveç rastit të parashikuar në nenin 57 të këtij ligji.”.

Neni 14

Në fund të nenit 56 shtohet një fjali me këtë përmbajtje:

“Në çdo rast tjetër, tatimpaguesi ka të drejtë në çdo kohë të tërheqë apelimin tatimor.”.

Neni 15

Fjalja e fundit e nenit 57 ndryshohet si më poshtë:

“Mosdërgimi brenda afatit i njoftimit për rezultatet e apelimit, nga shkalla përkatëse e apelimit tatimor, i jep të drejtën tatimpaguesit për t’u ankuar në shkallën tjetër më të lartë, pa paraqitur rezultatin e shqyrtimit të shkallës më të ulët.”.

Neni 16

Neni 62 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 62

Paraqitja e të dhënave dhe deklarimi

1. Tatimpaguesit janë të detyruar të paraqesin deklarata tatimore periodike në afatet dhe mënyrat e përcaktuara në ligjet e veçanta tatimore.

2. Organet tatimore u shpërndajnë tatimpaguesve, pa asnjë kusht, formularët e deklaratave një herë në 6 muaj. Mënyra dhe koha e shpërndarjes së tyre përcaktohen me udhëzim të veçantë. Fakti që një tatimpagues ose përfaqësues i tij nuk i ka marrë këto deklarata, nuk do të thotë që ai përjashtohet nga detyrimi i paraqitjes së deklaratës të plotësuar. Cilido që nuk e ka marrë këtë deklaratë duhet ta kërkojë atë në organin tatimor përkatës.”.

Neni 17

Neni 70 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 70

Konfirmimi i statusit të tatimpaguesit

Me kërkesën e tatimpaguesit, organet tatimore janë të detyruara të lëshojnë vërtetim për statusin tatimor të tatimpaguesit jo më vonë se 3 ditë pune nga data e kërkesës.”.

Neni 18

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**Shpallur me dekretin nr.4437, datë 17.12.2004 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,
Alfred Moisiu**

Fletorja Zyrtare gjendet:

Duke u abonuar për çdo vit pranë:

- çdo njësie postare të qyteteve;

- Qendrës së Publikimeve Zyrtare;

Bulevardi Zhan d'Ark, pranë ish-ekspozitës "Shqipëria Sot".

Tel: 042 555 63; 267 468

Pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare mund të gjeni:

BOTIMET:

1.	KUSHTETUTA (edhe anglisht)	600
2.	KODI I PROCEDURËS CIVILE	500
3.	KODI I PROCEDURËS PENALE	600
4.	KODI PENAL	400
5.	KODI I PUNËS	500
6.	KODI I FAMILJES	450
7.	KODI CIVIL	1000
8.	KODI RRUGOR DHE LIGJ PËR TRANSPORTIN	900
9.	KODI ZGJEDHOR	355
10.	KODI I PROCEDURAVE ADMINISTRATIVE	500
11.	DISPOZITA ZBATUESE TË KODIT RRUGOR	1500

PËRMBLEDHJE LEGJISLACIONI

1.	PËRMBLEDHJE E LEGJISLACIONIT NË FUSHËN E PËRMBARIMIT	800
2.	PËRMBLEDHJE E LEGJISLACIONIT NË FUSHËN E PROKURIMIT PUBLIK	1000
3.	PËRMBLEDHJE LEGJISLACIONI PËR NËPUNËSIN CIVIL	600
4.	PËRMBLEDHJE LEGJISLACIONI PËR SISTEMIN E DREJTËSISË	1500
5.	PËRMBLEDHJE NË FUSHËN E TAKSAVE DHE TATIMEVE	1500

DOLI NGA SHTYPI

TREGUESI KRONOLOGJIK I LEGJISLACIONIT SHQIPTAR 1990-KORRIK 2004	1500
TREGUESI TEMATIK I LEGJISLACIONIT SHQIPTAR 1990-KORRIK 2004	2000

Doli nga shtypi më 29.12.2004

Tirazhi: 4500 copë	Formati: 60x88/8
--------------------	------------------

Shtypshkronja Grafon
Tiranë, 2004

Çmimi 200 lekë